



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KONTRATË PËR FURNIZIM

E Lidhur më 19.08.2019 në mes të:

KUVENDIT KOMUNAL NOVOBËRDE

e Përfaqësuar nga z. **Fatos Ahmeti Menaxher i Prokurimit**, në njérën anë; dhe

NTSH Aome me seli në Prishtinë

E përfaqësuar nga znj. Hasim Makolli, ne anën tjetër.

Furnizim me Pelte (bio)për ngrohje për shkollën e mesme Ekonomike dhe Ambulanten ne fshatin LLabjan me numër Identifikues **NB 654 2019 013 136**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë Furnizim me Pelte (bio)për ngrohje për shkollën e mesme Ekonomike dhe Ambulanten ne fshatin LLabjan

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **DITEN E NENSHKRIMIT TE KONTRATES** dhe përfundon jo me gjatë se 20 dit Kalendarik

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi Shkolla e mesëme Ekonomike në fshatin LLabjan

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i menduar i kontratës do të jetë: 3.860.00€ [Tremij e tetqind e gjashtëdhjet euro]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vëtmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berëzës përkatëse, nëse aplikohet).

3.3 Menaxhimin e kësaj kontrate do ta bëj Menaxheri qe do te emërohet me vendim nga ana e kryetarit te komunës

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj pagesat pasi te jetë bërë furnizim dhe pranimi teknik i furnizimit nga ana e komisioni ,komision ky qe do te formohet nga Kryetari i komunës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i [shërbimeve] duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për një vit pas pranimit te pajisjes

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa

paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkonratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të rjoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njohimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkonratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmon ton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumë që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip] në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

| | | | |
|-------------|---|-------------|---|
| Emri: | <i>Hasim Haskoli</i> | Emri: | <i>FATOS ADRONI</i> |
| Pozita: | <i>PRONAR</i> | Pozita: | <i>MENAXHER</i> |
| Nënshkrimi: | <i>A.T.SH.</i> | Nënshkrimi: | <i>Patro 19</i> |
| Data: | <i>19.08.2019</i> | Data: | <i>19.08.2019</i> |
| Vula: |  | Vula: |  |

Sekcioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

| Nr. i Artikullit. | Përshkrimi | Njësie | Sasia e përafërt | Çmimi njësi € | Çmimi totali € |
|------------------------|------------------------|--------|------------------|---------------|----------------|
| 1. | Furnizim me Pelet(Bio) | Ton | 20 | 193 | 3.860,00 |
| Totali i Përgjithshëm: | | | | | |

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK

| | |
|------------------|-------------------------|
| EMRI I KOMPANIËS | H. T. SH " Aome " |
| ADRESA E PLOTE | Rr - Hasan Remni K - Pn |
| PËRFQËSUAR NGA: | |
| EMRI & MBIEMRI | Hasim Habeli |
| POZITA | Dpjetoq |
| NËNSHKRIMI | <u>He</u> |
| DATA | 23.07.2019 |
| VULË | |

